



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/117

Datë: 27.02.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet 109, 110, 111, 112 dhe 113 të Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/117

Datë: 27.02.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 15 të Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2013, mori:

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli Organizativ për Manifestimin gjithë-popullor për shënimin e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e cila do të organizohet nën patronatin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi më 5, 6 dhe 7 mars në këtë përbërje:

1.1.	Z. Agim Çeku, Ministër i Forcës së Sigurisë së Kosovës,	Kryesues;
1.2.	Z. Sami Lushtaku, Kryetar i Komunës së Skënderajt,	anëtar;
1.3.	Z. Memli Krasniqi, Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,	anëtar;
1.4.	Z. Faik Fazliu, Drejtor i Zyrës për Çështje të Veteranëve,	anëtar;
1.5.	Përfaqësues, Zyra e Protokollit të Kryeministrit,	anëtar;
1.6.	Përfaqësues, Protokolli i Shtetit, MPJ	anëtar.
2. Ndahen mjetet financiare në shumën prej 40,000.00 (dyzet mijë) euro të cilat do të shfrytëzohen sipas nevojës për manifestim.
3. Mjetet financiare nga pika 2. e këtij vendimi ndahen nga Rezervat e Qeverisë, dhe barten në kodin nr. 10700 në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime, në Zyrën e Kryeministrit.
4. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e pikës 2. dhe 3. të këtij vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/117
Datë: 27.02.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Avokatinë.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/117

Datë: 27.02.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për mënyrën e ofrimit të ndihmës Organeve Qeveritare nga Policia e Kosovës.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/117

Datë: 27.02.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Treguesi i Drejtësisë për Fëmijë.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e Treguesit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/117

Datë: 27.02.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2013, mori:

V E N D I M

PËR

**THEMELIMIN E EKITIT NEGOCIATOR PËR NEGOCIATAT E MARRËVESHJES SË
STABILIZIM ASOCIIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE BASHKIMIT
EVROPIAN**

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij vendimi është krijimi i Ekipit Negociator për drejtimin e përgatitjeve dhe negociatave të Qeverisë së Republikës së Kosovës për lidhjen e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian (më tej i referuar si Ekipi Negociator).

Neni 2
Përbërja e Grupit Negociator

1. Ekipi Negociator përbëhet nga:

- Kryesuesi, Ministri i Integritimit Evropian;
- Anëtar, Ministri i Punëve të Jashtme;
- Anëtar, Ministri i Drejtësisë;
- Anëtar, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë;
- Anëtar, Ministri i Financave;
- Anëtar, Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;

- Anëtar, Ministri i Zhvillimit Ekonomik;
- Sekretar, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Integrimit Evropian.

2. Nëse kërkohet me agjendë, në takimet e Ekipit Negociator, Kryesuesi mund të ftojë Ministra të tjerë, udhëheqës apo ekspertë të institucioneve të tjera shtetërore të Republikës së Kosovës.

Neni 3 Funksionet e Ekipit Negociator

1. Ekipi Negociator ka funksionet e mëposhtme:

- 1.1. të koordinoj politikë të njëtrajtshme shtetërore në negociatat me Bashkimin Evropian për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit;
- 1.2. të diskutoj pozitat negociuese dhe çdo çështje tjetër që ndërlidhet me negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit;
- 1.3. të veproj si delegacion i Republikës së Kosovës në takimet zyrtare në negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit;
- 1.4 të koordinoj përgatitjet e institucioneve shtetërore për negociatat e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
- 1.5. të informoj dhe t'i raportoj rregullisht Qeverisë dhe të gjitha institucioneve tjera relevante për të gjitha çështjet e hapura dhe progresin e arritur në negociatat në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit.

Neni 4 Ndërlidhja me Grupet Punuese për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian

Ekipi Negociator mund të autorizojë dhe të udhëzojë Grupet Punuese për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian të kryejnë detyra të caktuara brenda fushës së përgjegjësisë të tyre dhe të marrin pjesë në negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit.

Neni 5 Mbështetja administrative

Ministria e Integrimit Evropian do të jetë përgjegjëse për mbështetjen administrative të Ekipit Negociator.

Neni 6 Procesverbalet e mbledhjeve

Procesverbalet e mbledhjeve duhet të nënshkruhen nga Kryesuesi dhe shpërndahen tek të gjithë anëtarët e Ekipit Negociator dhe ministrat e tjerë apo titullarët e institucioneve shtetërore pjesëmarrëse në takime, brenda tri ditëve të punës pas mbajtjes së takimit.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/117
Datë: 27.02.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2013, mori:

V E N D I M

PËR

**RREGULLOREN E PUNËS SË EKIPIT NEGOCIATOR PËR NEGOCIATAT E
MARRËVESHJES SË STABILIZIM ASOCIIMIT NË MES TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
DHE BASHKIMIT EVROPIAN**

Neni 1

Qëllimi i Vendimit

Qëllimi i Rregullores së Punës është të përcaktojë detyrat dhe përgjegjësitë për Ekipin Negociator për Negociatat e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian (në tekstin e mëtejme të këtij vendimi si "Ekipi Negociator").

Neni 2

Organizimi i takimeve të Ekipit Negociator

1. Mbledhjet e Ekipit Negociator do të thirren nga Kryesuesi.
2. Ftesa, agjenda dhe materialet për takim do të dorëzohen nga Sekretariati për anëtarët e Ekipit Negociator jo më vonë se pesë ditë pune para takimit. Nëse ka arsye të justifikuara takim mund të thirret dhe materialet dorëzohen anëtarëve jo më vonë se dy ditë para takimit.

3. Procesverbali i takimit do të nënshkruhet nga Kryesuesi dhe do të shpërndahet nga Sekretariati për gjithë anëtarët e Ekipit Negociator brenda tri ditëve të punës pas mbajtjes së takimit.

Neni 3

Procedura e Vendim-marrjes së Ekipit Negociator

1. Vendimet, rekomandimet dhe/ose qëndrimet e Ekipit Negociator do të miratohen me konsensus.
2. Nëse ka nevojë për vendim politik apo nëse ndonjë anëtar i Ekipit Negociator ka qëndrim apo mendim të ndryshëm, çështja e hapur do të dokumentohet dhe të dorëzohet në Qeveri për zgjidhjen e saj.

Neni 4

Përfshirja e ekspertëve në punën e Ekipit Negociator

1. Kryetari i Ekipit Negociator mund të ftojë ekspertë për të ofruar mendime dhe rekomandime për çështje të veçanta që lidhen me fushën e veprimtarisë së Ekipit Negociator.

Neni 5

Metodologjia e unifikuar

Ministria e Integritimit Evropian do të ofrojë udhëzime përkatëse, informata mbi procesin e integritimit Evropian, si dhe do të sigurojë mbështetje administrative për Ekipin Negociator.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/117

Datë: 27.02.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2013, mori:

V E N D I M

PËR

**THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR NEGOCIIMIN E ÇËSHTJEVE
ADMINISTRATIVE DHE INSTITUCIONALE NË KUADËR TË MARRËVESHJES SË
STABILIZIM ASOCIIMIT**

Neni 1

Qëllimi i vendimit

Ky vendim themelon strukturën, përcakton fushë veprimtarinë dhe përbërjen e Grupit Punues për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Neni 2

Fushë veprimtaria e Grupit Punues

1. Grupi Punues është organ ndërqeveritar i themeluar për të shqyrtuar çështjet që lidhen me Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit.
2. Fushë veprimtaria e Grupit Punues është e përbërë nga këto fusha si në vijim:
 - Preambula dhe neni 1;
 - Titulli I për Parimet e Përgjithshme;
 - Titulli II për Dialogun Politik;
 - Titulli III për Bashkëpunimin Rajonal;

- Titulli X për Çështjet Institucionale, Dispozitat e Përgjithshme dhe Përfundimtare;
- Shtojcat dhe protokollet.

Neni 3 Përbërja e Grupit Punues

1. Grupi Punues përbëhet nga këta anëtarë:
 - 1.1. Kryesuesi, Zëvendës Ministri i Ministrisë së Integrimit Evropian;
 - 1.2. Zëvendës Kryesuesi, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Integrimit Evropian;
 - 1.3. Sekretariati, Udhëheqësi i Departamentit për Koordinimin e procesit të Stabilizim Asociimi në Ministrinë e Integrimit Evropian;
 - 1.4. Anëtarët e Grupit Punues janë:
 - Zyra e Kryeministrit;
 - Zyra Ligjore / Zyra e Kryeministrit;
 - Ministria e Punëve të Jashtme;
 - Ministria e Financave;
 - Ministria e Integrimit Evropian.
2. Anëtarët e Grupit Punues emërojnë përfaqësuesit e tyre dhe njoftojnë Kryesuesin dhe Sekretarin e Ekipit Negociator.
3. Kryesuesi i Grupit Punues mund të ftoj përfaqësues të institucioneve tjera të Republikës së Kosovës për të marrë pjesë në aktivitetet e Grupit Punues, në përputhje me çështjet për negociim në agjendë.
4. Kryesuesi, Zëvendës Kryesuesi dhe Anëtarët e Grupit Punues nuk do të marrin asnjë pagë shtesë për pjesëmarrjen e tyre në Grupin Punues.

Neni 4 Përgjegjësit e Grupit Punues

1. Grupi Punues ka këto përgjegjësi, si në vijim:
 - 1.1. Është përgjegjës për rrjedhën e negociatave për fushat, siç janë të përcaktuara në Nenin 2;
 - 1.2. Mbikëqyrë dhe udhëheqë negociatat për këto fusha;
 - 1.3. Zhvillon negociata dhe arrin marrëveshje për fushat e përcaktuara në Nenin 2;
 - 1.4. Shqyrton dhe aprovon draft propozimet për pozitat negociuese dhe i dërgon ato tek Ekipi Negociator;
 - 1.5. Përgatit dhe dorëzon një raport tek Ekipi Negociator për progresin e negociatave pas çdo takimi të negociatave me përfaqësuesit e BE-së.

Neni 5
Zbatimi

Institucionet në Nenin 3 të këtij vendimi janë të obliguara për zbatimin e këtij vendimi. Puna e Grupit Punues do të koordinohet nga Sekretari i Ekipit Negociator, në bashkëpunim të plotë me dhe sipas instruksioneve të dhëna nga Kryenegociatori.

Neni 6
Rregullat e Punës

Grupi Punues do të punoj në bazë të Vendimit për Rregullat e Punës për Grupet Punuese për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/117

Datë: 27.02.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2013, mori:

V E N D I M

PËR

**THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR NEGOCIIMIN E ÇËSHTJEVE TREGTARE NË
KUADËR TË MARRËVESHJES SË STABILIZIM ASOCIIMIT**

Neni 1

Qëllimi i vendimit

Ky vendim themelon strukturën, përcakton fushë veprimtarinë dhe përbërjen e Grupit Punues për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Neni 2

Fushë veprimtaria e Grupit Punues

1. Grupi Punues është organ ndërqeveritar i themeluar për të shqyrtuar çështjet që ndërlidhen me Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit.
2. Fushë veprimtaria e Grupit Punues është e përbërë nga këto fusha si në vijim:
 - Titulli IV për Lëvizjen e Lirë të Mallrave;
 - Kapitulli I për Produktet Industriale;
 - Kapitulli II për Bujqësinë dhe Peshkimin;
 - Kapitulli III për Dispozitat e Përgjithshme

- Titulli V për Lëvizjen e Punëtorëve, Ndërmarrjet, Ofrimi i Shërbimeve, Lëvizja e Kapitalit;
- Kapitulli I për Lëvizjen e Punëtorëve;
- Kapitulli II për Ndërmarrjet;
- Kapitulli III për Ofrimin e Shërbimeve;
- Kapitulli IV për Pagesat Rrjedhëse dhe Lëvizja e Kapitalit;
- Kapitulli V për Dispozitat e Përgjithshme (të referuara për Titullin V);
- Shtojcat dhe protokollet.

Neni 3 Përbërja e Grupit Punues

1. Grupi Punues përbëhet nga këta anëtarë:
 - 1.1. Kryesuesi, Zëvendës Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë;
 - 1.2. Zëvendës Kryesuesi, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë;
 - 1.3. Sekretariati, Udhëheqësi i Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë;
 - 1.4. Anëtarët e Grupit Punues janë:
 - Agjencia e Statistikave të Kosovës / Zyra e Kryeministrit;
 - Zyra Ligjore / Zyra e Kryeministrit;
 - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
 - Ministria e Punëve të Jashtme;
 - Ministria e Financave;
 - Ministria e Financave / Dogana e Kosovës;
 - Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
 - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
 - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
 - Ministria e Integritimit Evropian;
 - Banka Qendrore e Kosovës.
2. Anëtarët e Grupit Punues emërojnë përfaqësuesit e tyre dhe njoftojnë Kryesuesin dhe Sekretarin e Ekipit Negociator.
3. Kryesuesi i Grupit Punues mund të ftojë përfaqësues të institucioneve tjera të Republikës së Kosovës për të marrë pjesë në aktivitetet e Grupit Punues, në përputhje me çështjet për negociim në agjendë.
4. Kryesuesi, Zëvendës Kryesuesi dhe Anëtarët e Grupit Punues nuk do të marrin asnjë pagë shtesë për pjesëmarrjen e tyre në Grupin Punues.

Neni 4 Përgjegjësit e Grupit Punues

1. Grupi Punues ka këto përgjegjësi, si në vijim:
 - 1.1. Është përgjegjës për rrjedhën e negociatave për fushat, siç janë të përcaktuara në Nenin 2;
 - 1.2. Mbikëqyrë dhe udhëheqë negociatat për këto fusha;
 - 1.3. Zhvillon negociatat dhe arrin marrëveshje për fushat e përcaktuara në Nenin 2;

- 1.4. Shqyrton dhe aprovon draft propozimet për pozitat negociuese dhe i dërgon ato tek Ekipi Negociator;
- 1.5. Përgatit dhe dorëzon një raport tek Ekipi Negociator për progresin e negociatave pas çdo takimi të negociatave me përfaqësuesit e BE-së.

Neni 5
Implementimi


Institucionet në Nenin 3 të këtij vendimi janë të obliguara për zbatimin e këtij vendimi. Puna e Grupit Punues do të koordinohet nga Sekretari i Ekipit Negociator, në bashkëpunim të plotë me dhe sipas instruksioneve të dhëna nga Kryenegociatori.

Neni 6
Rregullat e Punës

Grupi Punues do të punoj në bazë të Vendimit për Rregullat e Punës për Grupet Punuese për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit


Hashim THAÇI

Kryeminister i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/117
Datë: 27.02.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2013, mori:

V E N D I M

PËR
THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR NEGOCIIMIN E ÇËSHTJEVE TË PUNËVE TË
BRENDSHME DHE DREJTËSI NË KUADËR TË MARRËVESHJES SË STABILIZIM
ASOCIIMIT

Neni 1
Qëllimi i vendimit

Ky vendim themelon strukturën, përcakton fushë veprimtarinë dhe përbërjen e Grupit Punues për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Neni 2
Fushë veprimtaria e Grupit Punues

1. Grupi Punues është organ ndërqeveritar i themeluar për të shqyrtuar çështjet që ndërlidhen me Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit.
2. Fushë veprimtaria e Grupit Punues është e përbërë nga këto fusha si në vijim:
 - Titulli VII për Drejtësi, Liri dhe Siguri;
 - Kapacitetet institucionale dhe sundimi i ligjit;
 - Mbrojtja e të dhënave personale;
 - Vizat, menaxhimi i kufijve, azili dhe migrimi;
 - Parandalimi dhe kontrolli i imigrimit, riatdhesimi;

- Shpërlarja e parasë dhe financimi i terrorizmit;
- Bashkëpunimi në luftë kundër substancave ilegale;
- Parandalimi dhe lufta kundër krimit të organizuar dhe aktiviteteve tjera të kundërligjshme;
- Lufta kundër terrorizmit;
- Shtojcat dhe protokollet.

Neni 3 Përbërja e Grupit Punues

1. Grupi Punues përbëhet nga këta anëtarë:
 - 1.1. Kryesuesi, Zëvendës Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme;
 - 1.2. Zëvendës Kryesuesi, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme;
 - 1.3. Sekretar, Udhëheqësi i Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
 - 1.4. Anëtarët e Grupit Punues janë:
 - Zyra e Kryeministrit;
 - Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit;
 - Ministria e Drejtësisë;
 - Ministria e Punëve të Brendshme;
 - Ministria e Punëve të Jashtme;
 - Ministria e Financave;
 - Ministria e Integrimit Evropian;
 - Agjencia Kundër Korrupsionit;
 - Këshilli Prokurorial i Kosovës;
 - Instituti Gjyqësor i Kosovës;
 - Këshilli Gjyqësor i Kosovës.
2. Anëtarët e Grupit Punues emërojnë përfaqësuesit e tyre dhe njoftojnë Kryesuesin dhe Sekretarin e Ekipit Negociator.
3. Kryesuesi i Grupit Punues mund të ftojë përfaqësues të institucioneve tjera të Republikës së Kosovës për të marrë pjesë në aktivitetet e Grupit Punues, në përputhje me çështjet për negociim në agjendë.
4. Kryesuesi, Zëvendës Kryesuesi dhe Anëtarët e Grupit Punues nuk do të marrin asnjë pagë shtesë për pjesëmarrjen e tyre në Grupin Punues.

Neni 4 Përgjegjësit e Grupit Punues

1. Grupi Punues ka këto përgjegjësi, si në vijim:
 - 1.1. Është përgjegjës për rrjedhën e negociatave për fushat, siç janë të përcaktuara në Nenin 2;
 - 1.2. Mbikëqyrë dhe udhëheqë negociatat për këto fusha;
 - 1.3. Zhvillon negociatën dhe arrin marrëveshje për fushat e përcaktuara në Nenin 2;
 - 1.4. Shqyrton dhe aprovon draft propozimet për pozitat negociuese dhe i dërgon ato tek Ekipi Negociator;

- 1.5. Përgatit dhe dorëzon një raport tek Ekipi Negociator për progresin e negociatave pas çdo takim të negociatave me përfaqësuesit e BE-së.

Neni 5
Zbatimi

Institucionet në Nenin 3 të këtij vendimi janë të obliguara për zbatimin e këtij vendimi. Puna e Grupit Punues do të koordinohet nga Sekretari i Ekipit Negociator, në bashkëpunim të plotë me dhe sipas instruksioneve të dhëna nga Kryenegociatori.

Neni 6
Rregullat e Punës

Grupi Punues do të punoj në bazë të Vendimit për Rregullat e Punës për Grupet Punuese për Zhvillimin e Negociatave dhe lidhjen e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/117
Datë: 27.02.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2013, mori:

V E N D I M

PËR
THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR NEGOCIIMIN E ÇËSHTJEVE TË
HARMONIZIMIT TË LEGJISLACIONIT NË KUADËR TË MARRËVESHJES SË
STABILIZIM ASOCIIMIT

Neni 1
Qëllimi i vendimit

Ky vendim themelon strukturën, përcakton fushë veprimtarinë dhe përbërjen e Grupit Punues për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Neni 2
Fushë veprimtaria e Grupit Punues

1. Grupi Punues është organ ndërqeveritar i themeluar për të shqyrtuar çështjet që lidhen me Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit.
2. Fushë veprimtaria e Grupit Punues është e përbërë nga këto fusha si në vijim:
 - Titulli VI për Përafrimin e Legjislacionit, Zbatimin e Ligjeve dhe Rregullat e Konkurrencës;
 - Konkurrenca dhe dispozitat të tjera ekonomike;
 - Ndërmarrjet publike;

- Pronësia intelektuale, industriale dhe komerciale;
- Prokurimi publik;
- Standardizimi, metrologjia, akreditimi dhe vlerësimi i konformitetit;
- Mbrojtja e konsumatorit;
- Kushtet e punës dhe mundësitë e barabarta.

Neni 3 Përbërja e Grupit Punues

1. Grupi Punues përbëhet nga këta anëtarë:
 - 1.1. Kryesuesi, Zëvendës Ministri i Ministrisë së Integrimit Evropian;
 - 1.2. Zëvendës Kryesuesi, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Integrimit Evropian;
 - 1.3. Sekretariati, Udhëheqësi i Departamentit të së Drejtës së BE-së në Ministrinë e Integrimit Evropian;
 - 1.4. Anëtarët e Grupit Punues janë:
 - Zyra e Kryeministrit;
 - Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit;
 - Ministria e Punëve të Jashtme;
 - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
 - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
 - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
 - Ministria e Financave;
 - Ministria e Financave / Dogana e Kosovës;
 - Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
 - Ministria e Integrimit Evropian;
 - Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik;
 - Autoriteti Kosovar i Konkurrencës.
2. Anëtarët e Grupit Punues emërojnë përfaqësuesit e tyre dhe njoftojnë Kryesuesin dhe Sekretarin e Ekipit Negociator.
3. Kryesuesi i Grupit Punues mund të ftojë përfaqësues të institucioneve tjera të Republikës së Kosovës për të marrë pjesë në aktivitetet e Grupit Punues, në përputhje me çështjet për negociim në agjendë.
4. Kryesuesi, Zëvendës Kryesuesi dhe Anëtarët e Grupit Punues nuk do të marrin asnjë pagë shtesë për pjesëmarrjen e tyre në Grupin Punues.

Neni 4 Përgjegjësit e Grupit Punues

1. Grupi Punues ka këto përgjegjësi, si në vijim:
 - 1.1. Është përgjegjës për rrjedhën e negociatave për fushat, siç janë të përcaktuara në Nenin 2;
 - 1.2. Mbikëqyrë dhe udhëheqë negociatat për këto fusha;
 - 1.3. Zhvillon negociatën dhe arrin marrëveshje për fushat e përcaktuara në Nenin 2;
 - 1.4. Shqyrton dhe aprovon draft propozimet për pozitat negociuese dhe i dërgon ato tek Ekipi Negociator;

- 1.5. Përgatit dhe dorëzon një raport tek Ekipi Negociator për progresin e negociatave pas çdo takimi të negociatave me përfaqësuesit e BE-së.

Neni 5
Zbatimi

Institucionet në Nenin 3 të këtij vendimi janë të obliguara për zbatimin e këtij vendimi. Puna e Grupit Punues do të koordinohet nga Sekretari i Ekipit Negociator, në bashkëpunim të plotë me dhe sipas instruksioneve të dhëna nga Kryenegociatori.

Neni 6
Rregullat e Punës

Grupi Punues do të punoj në bazë të Vendimit për Rregullat e Punës për Grupet Punuese për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/117
Datë: 27.02.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2013, mori:

V E N D I M

PËR

**THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR NEGOCIIMIN E POLITIKAVE TË
BASHKËPUNIMIT NË KUADËR TË MARRËVESHJES SË STABILIZIM ASOCIIMIT**

Neni 1

Qëllimi i vendimit

Ky vendim themelon strukturën, përcakton fushë veprimtarinë dhe përbërjen e Grupit Punues për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Neni 2

Fushë veprimtaria e Grupit Punues

1. Grupi Punues është organ ndërqeveritar i themeluar për të shqyrtuar çështjet që ndërlidhen me Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit.

1. Fushë veprimtaria e Grupit Punues është e përbërë nga këto fusha si në vijim:

- Titulli VIII për Politikën e Bashkëpunimit;
- Politikën ekonomike dhe tregtare;
- Bashkëpunimi në fushën e statistikave;
- Shërbimet bankare, të sigurimit dhe shërbimet të tjera financiare;
- Bashkëpunimi në fushën e kontrollit të brendshëm dhe auditimit të jashtëm;
- Mbrojtja dhe promovimi i investimeve;
- Bashkëpunimi industrial;
- Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;

- Turizmi;
- Bujqësia dhe sektori agro-industrial;
- Peshkataria;
- Doganat;
- Tatimet;
- Bashkëpunimi social;
- Arsimi dhe trajnimi;
- Bashkëpunimi kulturor;
- Bashkëpunimi në fushën audio-vizive;
- Shoqëria informative;
- Rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik;
- Komunikimi dhe informimi;
- Transporti;
- Energjia;
- Siguria nukleare;
- Mjedisi;
- Bashkëpunimi në hulumtim dhe zhvillim teknologjik;
- Zhvillimi lokal dhe rajonal;
- Administrata publike.
- Titulli IX për Bashkëpunim Financiar;
- Shtojcat dhe protokollet.

Neni 3

Përbërja e Grupit Punues

1. Grupi Punues përbëhet nga këta anëtarë:

- 1.1. Kryesuesi, Zëvendës Ministri i Ministrisë së Integrimit Evropian;
- 1.2. Zëvendës Kryesuesi, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Integrimit Evropian;
- 1.3. Sekretariati, Udhëheqësi i Departamentit për Koordinimin e procesit të Stabilizim Asociimit në Ministrinë e Integrimit Evropian;

1.4. Anëtarët e Grupit Punues janë:

- Agjencia e Kosovës e Statistikave / Zyra e Kryeministrit;
- Zyra e Kryeministrit;
- Zyra Ligjore / Zyra e Kryeministrit;
- Ministria e Punëve të Jashtme;
- Zyra e Auditorit të Përgjithshëm;
- Banka Qendrore e Kosovës;
- Doganat e Kosovës / Ministria e Financave;
- Administrata Tatimore e Kosovës / Ministria e Financave;
- Ministria e Financave;
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Ministria e Infrastrukturës;
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
- Ministria e Administratës Publike;
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;

- Ministria e Integrimit Evropian.

2. Anëtarët e Grupit Punues emërojnë përfaqësuesit e tyre dhe njoftojnë Kryesuesin dhe Sekretarin e Ekipit Negociator.

3. Kryesuesi i Grupit Punues mund të ftoj përfaqësues të institucioneve tjera të Republikës së Kosovës për të marrë pjesë në aktivitetet e Grupit Punues, në përputhje me çështjet për negociim në agjendë.

4. Kryesuesi, Zëvendës Kryesuesi dhe Anëtarët e Grupit Punues nuk do të marrin asnjë pagë shtesë për pjesëmarrjen e tyre në Grupin Punues.

Neni 4

Përgjegjësit e Grupit Punues

1. Grupi Punues ka këto përgjegjësi, si në vijim:

- 1.1. Është përgjegjës për rrjedhën e negociatave për fushat, siç janë të përcaktuara në Nenin 2;
- 1.2. Mbikëqyrë dhe udhëheqë negociatat për këto fusha;
- 1.3. Zhvillon negociata dhe arrin marrëveshje për fushat e përcaktuara në Nenin 2;
- 1.4. Shqyrton dhe aprovon draft propozimet për pozitat negociuese dhe i dërgon ato tek Ekipi Negociator;
- 1.5. Përgatit dhe dorëzon një raport tek Ekipi Negociator për progresin e negociatave pas çdo takimi të negociatave me përfaqësuesit e BE-së.

Neni 5

Zbatimi

Institucionet në Nenin 3 të këtij vendimi janë të obliguara për zbatimin e këtij vendimi. Puna e Grupit Punues do të koordinohet nga Sekretari i Ekipit Negociator, në bashkëpunim të plotë me dhe sipas instruksioneve të dhëna nga Kryenegociatori.

Neni 6

Rregullat e Punës

Grupi Punues do të punoj në bazë të Vendimit për Rregullat e Punës për Grupet Punuese për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/117
Datë: 27.02.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2013, mori:

V E N D I M

PËR
RREGULLAT E PUNËS PËR GRUPET PUNUESE PËR NEGOCIIMIN E
MARRËVESHJES SË STABILIZIM ASOCIIMIT

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i Rregullores së Punës është që të përcaktojë detyrat dhe përgjegjësitë për Grupet Punuese për Negociimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (në tekstin e mëtejme: Grupet Punuese).

Neni 2
Organizimi i mbledhjeve të Grupeve Punuese

1. Mbledhjet e Grupeve Punuese thirren nga Kryesuesi i Grupit Punues përkatës.
2. Ftesa, agjenda dhe materialet për mbledhje dorëzohen nga Sekretariati tek anëtarët e Grupeve Punuese jo më vonë se pesë ditë pune para takimit. Nëse ka arsye të justifikuara takimi mund të mblidhet dhe materialet i dorëzohen anëtarëve jo më vonë se dy ditë para takimit.
3. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryesuesi dhe shpërndahen prej Sekretariati për të gjithë anëtarët e Grupeve Punuese brenda tri ditëve të punës pas zhvillimit të takimit.

4. Kryesuesi i Grupit Punues është i obliguar të thërrasë mbledhjen me kërkesën e Udhëheqësit të Ekipit Negociator.

Neni 3

Procedura e Vendimmarrjes në Grupet Punuese

1. Vendimet, rekomandimet dhe/ose qëndrimet e Grupeve Punuese miratohen me konsensus dhe kanë efekt këshillues.
2. Nëse ka nevojë për vendim politik apo ndonjë anëtar i Grupeve Punuese ka qëndrime apo opinione të ndryshme, çështjet e hapura duhet të dokumentohen dhe paraqiten, varësisht nga çështja në Ekipin Negociator për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit për zgjidhjen e tyre.

Neni 4

Përfshirja e ekspertëve në punën e Grupeve Punuese

1. Kryesuesi i Grupit Punues mund të ftojë ekspertë për të ofruar mendime dhe rekomandime në çështje specifike që ndërlidhen me fushën e veprimtarisë së Grupit Punues.

Neni 5

Metodologjia e unifikuar

Ministria e Integrimit Evropian do të ofroj udhëzimet e nevojshme Grupeve Punuese për procesin e negocimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, bazuar në kërkesat dhe marrëveshjet me BE-në të cilat duhet të përmbushen me qëllim të negocimit të suksesshëm të MSA-së.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/117

Datë: 27.02.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Komisionit të Përhershëm Qeveritar për Kufijtë e Republikës së Kosovës për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 96,951.00 euro në kategoritë sipas kërkesës së Komisionit.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/117

Datë: 27.02.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 3 dhe 5 të Ligjit Nr. 03/L-87 për Ndërmarrjet Publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2013, mori:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në cilësinë e ushtruesit të ligjshëm të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës në Ndërmarrjen Publike "Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A" ("PTK"), vendos që Ministri i Financave ("Ministri"), autorizohet dhe urdhërohet të veprojë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si aksionar i vetëm në PTK, dhe të ndërmarrë të gjitha masat e ligjshme, të nevojshme dhe të përshtatshme të aksionarit për realizimin e veprimit në vijim në periudhën më të shkurtër kohore të mundshme ligjërisht:
 - 1.1. Të kërkojë nga PTK dhe Bordi i saj i Drejtorëve që menjëherë të deklarojnë dhe paguajnë një dividendë ("Dividenda") për aksionarin në shumën prej dyzet milion (40,000,000) euro.
2. Obligohet Ministri i Financave që në bashkëpunim me Ministrin e Zhvillimit Ekonomik dhe Bordin e Drejtorëve të Post dhe Telekomunikacionit Kosovës Sh.A të caktojë dinamikën e ekzekutimit të obligimit nga pika 1.1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/117
Datë: 27.02.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 38 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2013, mori:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, jep mendim në pajtim me nenin 38 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, dhe pajtohet me propozimet e bëra nga Paneli Seleksionues për Guvernator të Bankës Qendrore.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin së bashku me biografitë e të propozuarve t'ia procedojë Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/117

Datë: 27.02.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2013, mori:

V E N D I M

1. Lejohet shfrytëzimi i përkohshëm i pronës publike të zonave kadastrale Trudë dhe Bardh i Madh të cilat menaxhohen nga Agjencioni Pyjor i Kosovës për nevoja të ndërtimit të Autostradës R7.
2. Agjencioni Pyjor i Kosovës si menaxhues dhe shfrytëzues i pronave në zonat e identifikuar duhet të lejoj Ministrinë e Infrastrukturës, përkatësisht BE GP që të gërmoj dhe shfrytëzoj pa kushte materialin e nevojshëm i cili do të përdoret për mbushje, beton apo asfaltim për nevoja të zbatimit të projektit të ndërtimit të Autostradës R7.
3. Këto lokacione do të shfrytëzohen vetëm për qëllim të shfrytëzimit të materialit për ndërtimin e Autostradës në seksionin shtatë, tetë dhe nëntë apo nga kryqëzimi jugor i Prishtinës afër Fushë Kosovës deri të kryqëzimi verior i Prishtinës (Besi).
4. Pas përfundimit të punimeve në seksionet e 7, 8 dhe 9 të Autostradës, këto lokacione do t'i kthehen Agjencionit Pyjor të Kosovës.
5. Eksploatimi i materialeve nga këto lokacione do të jetë i liruar nga pagesat e tatimeve të parapara me procedurat e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeminister i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë